

Data 05.12.2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AGS Sh.A

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 66710000-0;

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,333,459 (shtatë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” , në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm

nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41 dhe 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenet e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit të marrëveshjes kuadër, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një tregues i rëndësishëm, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën për Ushtrimin e Veprimtarisë së Sigurimit të Jetës, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, në përputhje me Ligjin Nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Argumentimi: Vendorsja e këtij kriteri bazohet në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në Ligjin Nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit si dhe në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Shërbimi i sigurimit të jetës nuk mund të ofrohet nga çdo subjekt tregtar por vetëm nga ato subjekte të licensuara/autorizuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), ndaj duke qenë se është në proporcion me objektin e prokurimit të kësaj procedure vlerësojmë që operatorët ekonomikë ta disponojnë këtë dokument.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektivit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektivit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lirë, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendorsja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektivit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike

Termat e referencës janë hartuar nga grupi i punës bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor, si dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i

ndryshuar, e nenit 40/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, e Ligjit Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor...” i ndryshuar, e Ligjit Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar.

Shoqëria “Albanian Gas Service Company” SH.A është shoqëri italo-shqiptare e krijuar në bazë të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Trans Adriatic Pipeline AG (TAP) dhe ka si mision të saj mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit të gazsjellesit të ndërtuar nga TAP në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sigurimi i jetës dhe shëndetit i punonjësve është detyrim kontraktual me TAP si dhe politikë e brendshme dhe thelbësore për shoqërinë AGS sha sepse nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi mbron punonjësit dhe ul rreziqet financiare të saj, rrit performancën dhe besnikërinë e punonjësve, redukton mungesat në punë dhe përmirëson imazhin e tyre në treg. Për më tepër, që sigurimi i punonjësve është pjesë e standardeve ligjore dhe e praktikave moderne të menaxhimit, duke e bërë atë një investim të domosdoshëm në kompani.

Për shkak të veprimtarisë operationale që pothuaj është në terren pergjate shtritjes se te gjithë tubacionit te TAP por edhe administrative, AK për të garantuar sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës merr masa për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale duke ju siguruar punonjësve të vet trajtim mjekësor periodik dhe në rast sëmundjeje apo aksidenti, një sërë shërbimesh sipas përcaktimeve të bëra në termat e referencës. Në përcaktimin e zërave të shërbimeve mjekësore AK është bazuar në Ligjin Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor...”, i ndryshuar ku përcaktohet “një paketë shërbimesh” të detyrueshme por edhe në nevoja të tjera shtesë të shoqërisë tonë duke përcaktuar një paketë me shërbime shtesë mjekësore përtej paketës bazë të ofruar nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm.